



Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete,
Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e
Agjencisë kundër Korrupsionit



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. 'Rexhep Luci'. 10/5
Prishtinë, 10 000, Kosovë
Ueb-site: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 227 944

Data: 23 Shtator 2016

Nga: Grupi për Studime Juridike dhe Politike

REKOMANDIME

**të dala nga Diskutimi Publik mbi “Progresi në Zbatimin e MSA-së: Sfidat në
agjendën evropiane dhe reformat në sundimin e ligjit”**

(mbajtur më datë 19.09.2016)

1. Hyrje

Pas më shumë se gjashtë muaj të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociimin, tanimë gëzimi i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje është kthyer tek fokusi i zbatimit të saj. Për të studiuar gjashtëmujorin e parë të hyrjes në fuqi të MSA-së, *Komisioni Integritet Evropian* në bashkëpunim me *Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GSJP)* mbajtën Diskutimin Publik lidhur me progresin e deritanishëm në zbatimin e Planit të Veprimit të MSA-së, dhe rolin që duhet të luaj i gjithë spektri institucional dhe politik për ta bërë më të lehtë zbatimin dhe për të rritur përgjegjësinë e institucioneve publike në këtë proces. Me qëllim të strukturimit më të mirë të diskutimit, ky takim u nda në dy sesione: *Sesioni I: Sfidat e përgjithshme lidhur me MSA-në dhe Procesi i Integritet Evropian dhe Sesioni II: Reformat e kërkuara në kuadër të MSA-së për fuqizimin e sundimit të ligjit*. Panelistë dhe pjesëmarrës në këtë diskutim, përveç anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian ishin edhe Përfaqësuesja e Be-së në Kosovë znj. Apostolova, ambasadorë dhe përfaqësues të ambasadës holandeze, gjermane, italiane, austriake kroate dhe sllovaqe, përfaqësues të Ministrisë së Integritet Evropian dhe Ministrisë së Drejtësisë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediave.

Më poshtë mund të gjeni të listuar rekomandimet e dala nga tryeza e datës 19.09.2016. Këto rekomandime do t'i dorëzohen Komisionit për Integritet Evropian dhe do të shqyrtohen në njërin nga takimet e tyre.

2. Rekomandimet

Në vazhdim mund t'i gjeni rekomandimet e dala nga tryeza.

Rekomandimi 1

(Të përgjithshme)

- **Konsensus politik në procesin integruar** -Panelistët dhe pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e procesit integruar pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. U theksua se ky proces do të marrë kohë të gjatë dhe kërkon profesionalizëm por mbi të gjitha konsensus politik. Partitë politike përherë duhet të gjejnë një konsensus mes tyre, për t'i qar përpara këto procese. Asnjëherë nuk bën të ketë veprime dhe bllokada që mund ta stagnojnë këtë proces, apo edhe ta kthejnë mbrapa. Prandaj, partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre duhet të gjejnë përherë një gjuhë të pajtimit dhe konsensusit kur bëhet fjale për procesin integruar të vendit.
- **Bashkëpunimi i Qeverisë dhe Kuvendit e shoqërinë civile** –përfaqësuesit ndërkombëtarë kërkuar një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet qeverisë dhe Kuvendit me shoqërinë civile gjatë procesit të integrimit të Kosovës. Ato kërkuar këtë bashkëpunim veçanërisht gjatë ndërtimit të institucioneve të afta për të përmbushur detyrimet e dala nga MSA-ja. Po ashtu u kërkuar një më shumë aktivitet i shoqërisë civile, por edhe i opozitës kosovare gjatë këtij procesi, ngase integrimet i përkasin të gjithëve dhe të gjithë duhet të angazhohen gjatë këtij procesi. Vetëm përmes një shoqërie civile aktive dhe një opozite konstruktive dhe aktive, procesi integruar i Kosovës mund të jetë i suksesshëm.
- **Rritja e nivelit të punës** – panelistët dhe të ftuarit u pajtuan që në këtë gjashtëmujor pas hyrjes në fuqi të MSA-së nuk janë përmbushur as gjysma e veprimeve të parashikuara me Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së. Kosova vazhdon të jetë shteti i fundit në rajon sa i përket procesit të integrimi dhe me këtë nivel të punës, anëtarësimi i Kosovës në BE do të zgjaste dy-deri në trefish më gjatë sesa që është planifikuar. Prandaj, Qeveria, Kuvendi dhe të gjithë institucionet tjera duhet t'u përmbahem PKZMSA-së gjatë punës së tyre dhe t'i kryejnë veprimet e kërkuara me efikasitet dhe sa më cilësor.

Rekomandimi 2

(Dialog me qytetaret gjatë procesit të integrimeve)

- Procesi i integrimit është edhe proces transformimi. Gjatë këtij procesi nuk reformohen vetëm institucionet dhe tregu që të jetë i konkurrueshëm në tregun e BE-së, por transformohen edhe shoqëritë. BE ka lindur nga ideja e tejkalimit të konflikteve, nga nevoja për paqe, bashkëpunim dhe mirëkuptim.
- Prandaj, ky proces duhet t'u shpjegohet edhe qytetarëve të Kosovës. Qeveria dhe Kuvendi duhet t'i shtojnë mekanizmat e dialogut me qytetarët e vendit për të kuptuar procesin integrues të vendit. Kuvendi dhe Qeveria duhet të shtojnë mekanizmat për të filluar një dialog të drejtpërdrejtë me qytetarët lidhur me procesin integrues. Qytetarët duhet të kuptojnë rëndësinë e këtij procesi dhe rolin që kanë. Ata duhet të kuptojnë rëndësinë e fqinjësisë së mirë dhe mundësitë që u hapën përmes këtij procesi si liria e lëvizjes, mundësitë lehtësuese për zhvillim të një biznesi, njoftimi dhe shkëmbimi me kultura të ndryshme etj.

Rekomandimi 3

(Emërimi i ekspertëve në institucionet shtetërore)

- Panelistët theksuan se me gjithë investimet dhe reformat që janë bërë në administratën shtetërore dhe agjencitë e pavarura, kualiteti i të punësuarve dhe punës në këto institucione mbetet i dobët. Procesi i integrimeve evropiane në përgjithësi dhe përmbushja e MSA-së në veçanti kërkojnë një administratë të profesionalizuar dhe me ekspertë në fusha të caktuara. Ky proces do të kërkojë edhe themelimin e agjencive dhe departamenteve të specializuara që do të merren me zbatimin e legjislacionit përkatës dhe përzgjedhja e stafit adekuat do të kërkojë vëmendje të shtuar, meqë nga puna e këtyre agjencive varet edhe përmbushja e detyrimeve.
- Panelistët, e veçanërisht ata ndërkombëtarë, kërkuan nga Kuvendi dhe qeveria që gjatë emërimit të zyrtarëve në pozita të ndryshme, veçanërisht ato që kanë të bëjnë direkt me përmbushjen e detyrimeve të dala nga MSA, të emërohen persona ekspert të fushës dhe me kredibilitet të lartë profesional e moral.

Rekomandimi 4

(Sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit)

- Të gjithë panelistët dhe pjesëmarrësit u pajtuan që sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit janë parakushtet kryesore për zbatimin MSA-së.
- Pa një shtet ligjor Kosova nuk mund të realizon shumicën e obligimeve të dala nga MSA-ja siç janë siguria juridike, mbrojtja e pronësisë industriale, ofrimi i gjykimit të shpejtë dhe të paanshëm në rast të ndonjë kontesti ekonomik, shkatërrimin e monopoleve dhe kartelevë tregtare etj. Prandaj, për plotësimin dhe zbatimin e obligimeve të dala në procesin integruar, sundimi i ligji paraqitet si parakusht dhe domosdoshmëri për të vazhduar rrugën e integritetit evropian.
- Nga të gjithë panelistët me theks të veçantë u përmend lufta kundër korrupsionit. Në të gjitha raportet e Komisionit Evropian, por edhe në raporte ndërkombëtare, korrupsioni paraqitet si problem kryesor i Republikës së Kosovës, duke u bërë madje edhe kushti kryesor për liberalizim të vizave. Të gjithë kërkuar një qasje me serioze me këtë fenomen, duke kërkuar nga Kuvendi nxjerrjen e ligjeve adekuate për të luftuar këtë fushë dhe mbikëqyrje më të madhe të institucioneve që merren me luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Rekomandimi 5

(Konkretizimi i vërejtjeve gjatë procesit integruar)

- Panelistët e veçanërisht deputetët e Kuvendit të Kosovës kërkuar që raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me punën e institucioneve të vendit në procesin integruar të jenë më konkrete.
- Fatkeqësisht një sërë raportesh të rëndësishme shpesh nuk kanë të përgjithësuara gjatë dhënies së rekomandimeve të tyre për punën e institucioneve vendore dhe rrjedhimisht ka pasur problem gjatë zërthimit të tyre. Përmes rekomandimeve dhe vërejtjeve konkrete, Kuvendi, qeveria dhe çdo institucion tjetër do të jetë në gjendje të shoh (mos) veprimet e saja dhe të veproj në harmoni me rekomandimet konkrete në raport. Përmes konkretizimit po ashtu i ikët paqartësisë dhe kështu askush nuk mund të fshehet më pas një raporti të paqartë apo përgjithësues.

Rekomandimi 6

(Afatizim dhe bashkërendim gjatë aktivitetëve)

- **Afatizimi i punës** -MSA është e lidhur për një afat prej 10 vitesh. Vet procesi integrues i vendit është një maratonë në kohë e cila zgjatet me çdo mosrespektim i afatit të paravendosur.
- Panelistët vunë në pah rëndësinë e kryerjes së detyrave të përcaktuar në afatin kohor. Çdo periudhë i ka prioritetet e tyre dhe moskryerja në kohë e një prioriteti pengon kryerjen e prioriteteve të planifikuara për të ardhmen dhe kështu rrjedhimisht bëhet një grumbullim i punëve të pakryera që shon në dëm të procesit integrues. Prandaj Panelistët kërkuar që detyrimet e dala nga MSA të kryhen secila në kohën e përcaktuar me PKZMSA. Aktualisht as gjysma e verimeve të përcaktuar për gjashtëmujorin e parë nuk janë kryer, që do të thotë se ato detyrime shtyhen për të ardhmen duke penguar kështu procesin normal të përcaktuar me PKZMSA.
- Në këtë rrafsh, panelistët u pajtuan që Kuvendi dhe veçanërisht Komisioni duhet t'i mbajë përherë në përgjegjshmëri institucionet qeveritare dhe agjencitë e pavarura lidhur me kryerjen e detyrimeve të marra përsipër me PKZMSA. Këtu Komisioni duhet të luajë një rol shumë më aktiv dhe i mbështetur dhe ndihmuar edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore.
- Bashkërendimi institucional - Procesi i integrimi është një proces kompleks dhe i ndërthurur ndërmjet shumë institucioneve. Përzierja apo paqartësia e ndarjes së kompetencave apo edhe mos-komunikimi ndërmjet institucioneve, nga praktika e vendeve të tjera që kanë kaluar nëpër këtë proces, ka rezultuar me zhargitje dhe shpeshherë dëmtim të procesit.
- Prandaj të gjitha institucionet e Kosovës duhet të bashkërendojnë punët e tyre. Ky bashkërendim duhet të bëhet ndërmjet ministrive, qeverisë, Kuvendit dhe institucioneve të tjera, por edhe ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre të BE-së me qëllim që secili të dijë detyrat dhe bashkëpunimin e nevojshëm që duhet të ketë gjatë përmbushjes së detyrimeve të dala nga MSA.

Rekomandimi 7

(Miratimi i ligjit për konflikt interesi)

- Janë me qindra e mijëra zyrtarë shtetërorë që mbajnë dy e më shumë pozita në hierarkinë shtetërore, edhe pse kjo paraqet konflikt interesi.
- Të pranishmit, u pajtuan që Qeveria e Kosovës duhet të hartoj sa më shpejt projektligjin për konflikt interesi. Veçanërisht deputetët e KIE-s kërkuan që Qeveria të sjellë sa më shpejtë në Kuvend këtë projektligj, sidomos pasi janë bërë një sërë komentesh nga Komisionet parlamentare dhe në fund qeveria vendosi të tërheq dy herë këtë projektligj nga Kuvendi, pa dhënë asnjë arsyetim

Rekomandimi 8

(Rishikimi i ligjit për konfiskim të pasurisë)

- Komisioni për Integritet Evropian në vitin 2016 ka monitoruar Ligjin nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë të fituar me veprë penale. Nga ky monitorim kanë dalë mbi 13 rekomandime për qeverinë e Kosovës dhe institucione tjera. Megjithatë asnjë rekomandim nuk është marrë parasysh nga Qeveria e Kosovës.
- Qeveria e Kosovës duhet t'i marr parasysh vërejtjet e Komisionit parlamentar për Integritet evropian dhe të njëjtat t'i përfshijë në plotësim-ndryshimin e ligjit të lartcekur.
- Me legjislacionin aktual, konfiskimi i pasurisë hasë në shumë pengesa që shpesh pamundësojnë konfiskimin dhe sekuestrimin me kohë të pasurisë. Përmes ndryshimeve të ofruara nga KIE për këtë ligj, konfiskimi i pasurisë bëhet më efikase dhe luftimi i krimeve si korrupsioni, nepotizmi dhe krimi i organizuar do të luftoheshin me efikasitet të shtuar.

Rekomandimi 9

(Shqyrtimi projektligjeve në procedurë të rregullt)

- Në shumë raporte ndërkombëtare dhe vendore, por edhe nga vërejtjet e panelistëve u diskutua edhe problemi i miratimit të ligjeve në procedurë të përsheptuar. Kjo procedurë zakonisht ndikon që projektligjet të kalojnë pa një shqyrtim të mirëfilltë dhe kështu Kuvendi figuron si një “motor miratues i

ligjeve” sesa një organ që shqyrton në përpikëri projektligjet deri në miratimin e tyre.

- Të pranishmit propozuan që Kuvendi të kufizoj, qoftë edhe përmes rregullores së punës mundësinë e shfrytëzimit të pafund të së drejtës për procedurë të përshpejtuar gjatë shqyrtimit të projektligjeve. Kjo ka ndikuar që një sërë ligjesh të futën në procedurë për plotësim-ndryshim ende pa u zbatuar plotësisht, vetme e vetëm pse u miratuan në procedurë të përshpejtuar duke mos pasur kohë të analizohen sa duhet.
- Sidomos tani kur nga Kuvendi kërkohet një kujdes i shtuar gjatë përafrimit të legjislacionit me atë të BE-s, shqyrtimi i projektligjeve në procedurë të rregullt është mese e domosdoshme.